



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 25.5.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË
KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Blerina Krasniqi (udhëheqëse ekipi), Alban Shatri dhe Vjosë Bojku (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Astrit Bllaca.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	30
5 Qeverisja e mirë.....	31
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	35
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	38
Shtojca III: Letër konfirmimi	48

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 27.10.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i MKRS.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kundërt me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale për shkak se janë kryer pagesa në mungesë të raporteve, pagesa pa bazë ligjore si dhe mjete të bartura në saldot e llogarive të paautorizuara të institucioneve vartëse.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjendja e pasurisë nuk ka mundur të konfirmohet pasi që ministria nuk kishte ofruar informatat e kërkuara.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrit në auditimin 2017**

Ministri është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e MKRS. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kundërt me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalesjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion të kundërt

Çështjet të cilat kanë ndikuar në bazën për opinion të kundërt janë si në vijim:

1. Llogaritë bankare të institucioneve vartëse janë në bankat komerciale, menaxhohen nga drejtorët dhe nuk janë të autorizuar nga thesari. Ministria, kohë pas kohe derdh mjete nga kategoria e subvencioneve dhe investimeve kapitale në këto llogari me qëllim të financimit të aktiviteteve të ndryshme të këtyre institucioneve. Si rezultat i kësaj në fund të vitit në llogaritë e institucioneve kishin mbetur 2,430,707€ mjete të pashpenzuara. Këto mjete janë prezantuar si shpenzime në Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

2. Instituti Arkeologjik i Kosovës (IAK) dhe MKRS kanë kompensuar punëtorët profesional dhe punëtorët ndihmës në teren, të angazhuar në realizimin e projekteve të trashëgimisë kulturore në vlerë 526,730€, sipas rregullores nr. 01/2009 për pagesën e punëtorëve në teren, e cila është shfuqizuar me vendim të Qeverisë. Për këtë çështje ishte modifikuar opinionioni edhe në vitin e kaluar;
3. MKRS në bazë të Memorandumeve të Mirëkuptimit, të nënshkruara me institucionet vartëse të saj si Instituti Arkeologjik i Kosovës dhe Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore me qëllim të realizimit të 30 projekteve ka kryer pagesa në vlerë 1,175,026€, mirëpo pagesat e tilla janë certifikuar në mungesë të dokumentacionit përcjellës. Kjo ishte në kundërshtim me Rregullën Financiare të Thesarit 01/2013 Për Shpenzimin e Parasë Publike.; dhe
4. Projekte të pa arsyetuara me dokumente mbështetëse nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në vlerë 1,843,534€. Institucionet vartëse të ministrisë, federatat dhe OJQ-të nuk kishin arsyetuar projektet e përfituara në kohën e paraparë dhe në përputhje me nenin 20 të rregullores së subvencioneve të MKRS i cili përcakton mënyrën e mbylljes së projekteve.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore, ZKA është e pavarur nga Ministria dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kundërt.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se MKRS nuk kishte ofruar informatat e nevojshme për testim të pasurive, të tilla si pronësia e pasurive, informata mbi projektet kapitale të përfunduara për të cilat duhet bërë transferi kapital në komuna përkatëse, informata nëse projektet e tilla ishin investime të reja apo rinovim i pasurive ekzistuese. Vlera e pasurisë kapitale (mbi 1000 euro) në MKRS është 23,287,695€. Pjesa dërmuese e këtyre pasurive (99%) apo pasuri në vlerë prej 23,061,300€ janë të paraqitura si investime në vijim. Për më tepër, MKRS ende nuk ka bërë përparime sa i përket identifikimit, vlerësimit dhe regjistrimit të objekteve dhe pronave të saj, prandaj regjistri i pasurisë ende nuk paraqet pasuritë totale, dhe si i tillë është jo i besueshëm. Pasiguria në lidhje me vlerën neto të pasurive vjen edhe për faktin që raporti i inventarizimit të pasurive nuk ishte harmonizuar me regjistrin e pasurive, dhe rrjedhimisht kjo nuk ishte reflektuar as në vlerën e pasurive të prezantuara në PFV.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur

përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë dhe Institucioneve Vartëse.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigorisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MKRS kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Kërkesat tjera (kërkesat buxhetore, raportet tremujore duke i përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore dhe planin e prokurimit).

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur.

Çështjet e prezantuara tek opinioni i auditimit, Ministria nuk ka mundur t'i korrigjojë gabimet, pasi që shpenzimet kishin ndodhur.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I MINISTRISË

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale, të cilat janë paraqitur tek nënkapitulli 2.1 Opinioni auditimit.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipër përmendura tek baza për opinion të kundërt dhe theksim të çështjes jepen rekomandimet:

- Rekomandimi 1** Ministri në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Thesarin duhet të gjejnë alternativa të përshtatshme që pagesat nga këto institucione vartëse të kryhen përmes llogarive të thesarit.
- Rekomandimi 2** Ministri duhet të siguroj që, në bashkëpunim me këshillin drejtues të IAK të hartojë politika apo udhëzime gjithëpërfshirëse për pagesën dhe angazhimin e punonjësve për realizimin e projekteve.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të siguroj që kontrollet lidhur me shpenzimin e parasë publike janë duke funksionuar, ashtu që pagesat për projektet kapitale të realizohen në përputhje të plotë me Rregullën Financiare të Thesarit 01/2013 Për Shpenzimin e Parasë Publike.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të siguroj se të gjitha projektet e Institucioneve Vartëse, Federatave dhe OJQ-ve duhet të arsyetohen në kohën e paraparë dhe me dokumentet mbështetëse valide të parapara me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe transfereve.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të siguroj se zyrtarët përgjegjës posedojnë informatat në lidhje me regjistrin e pasurisë dhe të njëjtat do të ofrohen tek ZKA. Për projektet e përfunduara të finalizoj procesin për bartjen e pronësisë tek komunat. Poashtu, duhet të formojë komision të veçantë për identifikimin, vlerësimin e pronave dhe objekteve të MKRS. Raporti i inventarizimit duhet të harmonizohet me regjistrin e pasurisë dhe kjo të reflektojë në PFV.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Për shkak të moszbatimit me konsistencë të rregulloreve, fusha e subvencioneve dhe prokurimit vazhdojnë të mbeten fusha më shqetësuese. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive - por kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar pa rregullsinë e shpenzimeve dhe shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi dhe realizimi i buxhetit, menaxhimi i subvencioneve, menaxhimi i pasurisë dhe certifikimi i pagesave të parregullta.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	33,539,942	25,284,697	24,408,173	18,874,393	16,773,166
Granti i Qeverisë -Buxheti	28,469,439	25,146,302	24,342,201	17,598,684	16,378,178
Të bartura nga viti paraprak ² -	-	18,729	15,579	6,003	9,416
Të hyrat vetjake ³	70,503	70,503	36,675	4,224	4,869
Donacionet e brendshme	-	2,398	343	-	-
Donacionet e jashtme	-	46,764	13,375	1,265,482	388,375
Te hyrat nga AKP	5,000,000				

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 8,255,245€, ky zvogëlim ishte me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2017, MKRS ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 24,408,173€, që është 2% më pak, krahasuar me vitin 2016. Përkundër kësaj, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm, duke marrë parasysh se në llogaritë bankare të 16 institucioneve vartëse në fund të vitit, kishin mjete të pashpenzuara në vlerë 2,430,708€. Kjo do të thotë që, në PFV-të e Ministrisë këto mjete figurojnë si shpenzime, në fakt ato nuk janë shpenzuar. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	33,539,942	25,284,697	24,408,173	16,773,166	18,874,393
Pagat dhe Mëditjet	4,087,814	4,086,547	4,073,999	3,560,945	3,390,057
Mallrat dhe Shërbimet	1,045,986	1,617,942	1,453,497	1,363,229	1,552,779
Shërbimet komunale	361,908	383,933	343,867	308,555	292,866
Subvencionet dhe Transferet	7,206,550	8,723,413	8,583,046	7,060,865	7,387,185
Investimet Kapitale	20,837,684	10,472,862	9,953,762	4,479,572	6,251,506

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte më i ultë nga buxheti fillestar për 1,267€. Fillimisht kishte një rritje nga donacionet 732€, pastaj me vendim të qeverisë janë shtuar 4,377€ dhe në fund me rishikim të buxhetit pagat dhe mëditjet u reduktuan për 6,376€. Realizimi ishte 99% e buxhetit final;
- Tek mallrat dhe shërbimet kishte rritje për 571,955€ në krahasim me buxhetin fillestar, ndërsa realizimi në fund ishte në nivel 90% e buxhetit final. Rritja e buxhetit përfshin transferin nga investimet kapitale prej 471,000€, rritja me rishikim të buxhetit 7,000€, të hyrat e bartura 18,728€, nga donacionet 47,370€ dhe 27,857€ me vendim të qeverisë. Në këtë kategori në fund të vitit kishte një suficit prej 164,445€, përderisa kishte edhe obligime të papaguara me arsyetimin se kishte mungesë të mjeteve. Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e transfereve është bërë për pagesën e punëtorëve të angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta (shërbimeve kontraktuese tjera);
- Buxheti për komunalitet ishte rritur për 22,025€. Me rishikim të buxhetit kemi një zvogëlim për 7,000€, ndërsa 29,025€ janë shtuar me transfer nga investimet kapitale;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte më i lartë për 1,516,863€ krahasuar me atë fillestar, ndërsa janë shpenzuar 98% e buxhetit final. Rritja me rishikim të buxhetit ishte për 360,000€, transfer nga investimet kapitale 1,062,000€, dhe me vendim të qeverisë 94,863€; dhe

- Buxheti final i investimeve kapitale ishte më i ultë për 10,364,822€. Kjo ishte si rezultat i transferit në linjat tjera në vlerë 1,512,000€, reduktimit me rishikim të buxhetit 5,410,000€, dhe reduktimit me vendime të qeverisë në vlerë 3,442,822€. Ndryshimet kaq të mëdha në këtë kategori kanë ardhur si rezultat i planifikimit jo të mirë dhe analizimit të mangët të faktorëve që ndikojnë në realizimin e buxhetit. Realizimi ishte 95% e buxhetit final. Edhe në këtë kategori në fund të vitit kishte një suficit prej 519,100€, ndërsa kishte edhe obligime të papaguara me arsyetimin se kishte mungesë të mjeteve.

Çështja 6 – Realizimi i buxhetit

E gjetura

Edhe pse buxheti final është realizuar në masën 96%, edhe këtë vit MKRS nuk kishte performancë të mirë, për arsye se gjatë vitit është shfaqur nevoja për shumë përshtatje, në shumicën e kategorive të shpenzimeve. Kjo ka ndodhur pasi që, menaxhmenti nuk kishte analizuar në baza të rregullta ecuritë buxhetore kundrejt projekteve të synuara. Po ashtu, në rritjen e përqindjes së realizimit të buxhetit ka ndikuar edhe bartja e një sasive të konsiderueshme të mjeteve në llogaritë bankare të Institucioneve Vartëse, ndërsa këto mjete në fund kanë mbetur si saldo e pashpenzuar.

Institucionet vartëse të kulturës në MKRS nuk planifikojnë buxhetin e tyre dhe nuk kanë kode buxhetore, siç kërkohet me ligjet e veçanta të disa prej tyre, mirëpo për ta realizuar veprimtarinë e tyre, MKRS i financon ato nga linja e subvencioneve dhe transfereve.

Për vitin 2017, me buxhet fillestar ishin të parapara gjithsej 89 projekte kapitale në vlerë totale prej 16,257,684€, mirëpo, si rezultat i mosrealizimit të projekteve kapitale sipas planit nga ana e MKRS, me rishikim të buxhetit i ishin larguar 17 projekte në vlerë 1,835,000€. Më tej, nga 72 projektet e parapara me buxhet final, për 6 projekte me vlerë 324,000€, nuk ishte shpenzuar fare gjatë viti 2017.

Sekretari i Përgjithshëm kishte lidhur memorandume të bashkëpunimit me 27 Federata Sportive dhe me Komitetin Olimpik të Kosovës në vlerë 2,743,000€, kjo vlerë është për 637,582€ më shumë se sa buxheti i paraparë për këtë qëllim (buxheti i ndarë 2,105,418€ në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve). MKRS në fund të vitit kishte arritur të siguronte mjete shtesë për pagesën e një pjesë të tyre, përkundër kësaj kishin mbetur obligime në vlerë 385,367€.

Rreziku Nevojat e shumta për përshtatje, janë tregues që përgatitja e buxhetit nuk është bazuar në kapacitetet reale të MKRS-së për realizimin e tij. Mos planifikimi i buxhetit nga ana e institucioneve vartëse dhe financimi i tyre nga MKRS përmes linjës së subvencioneve dhe transfereve rrit rrezikun e pagesave të parregullta, të keq klasifikuara dhe në mosarritjen e objektivave të atyre institucioneve. Mos realizimi i projekteve të rëndësishme kapitale dhe diferencat e theksuara mes planifikimit dhe shpenzimit, rrisin rrezikun që të mos arrihen objektivat e përcaktuara të Ministrisë. Mbetja e mjeteve në llogaritë e Institucioneve Vartëse ndikon në paraqitjen jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

Rekomandimi 6 Ministri duhet të sigurojë që përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit në mënyrë që mos të ketë përshtatje dhe diferenca të theksuara ndërmjet planifikimit dhe shpenzimit të mjeteve. Po ashtu është e nevojshme që të bëhen përpjekje për ndarjen e nën kodeve buxhetore të veçanta për secilin Institucion vartës të kulturës në mënyrë që Institucionet të planifikojnë buxhetin e tyre. Përveç kësaj, duhet të merren masat e nevojshme në mënyrë që të realizohen të gjitha projektet kapitale të parapara me buxhet si dhe të mos merren obligime financiare përmes marrëveshjeve derisa paraprakisht nuk janë siguruar mjetet.

3.2 Të hyrat

MKRS nuk ka plan për inkasimin e të hyrave ndërsa të hyrat e realizuara në 2017 ishin 85,330€. Krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje prej 68%. Në këtë rritje kishte kontribuar edhe shitja e automjeteve të MKRS. Këto të hyra kanë të bëjnë me shitjen e biletave për shfaqje, koncerte, pëlqime etj.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Megjithatë janë një sërë kontrollesh të cilat operojnë në kuadër të MKRS-së, e të cilat ndërlidhen me autorizimin e listës së pagave, verifikimin e ndryshimeve, rishikimin e buxhetit për këtë kategori, barazimet me thesarin etj. Prandaj është e rëndësishme që të ketë kontrolle efektive për të siguruar se këto veprime janë në përputhje me rregullat e përgjithshme.

Çështja 7 – Kompensime të parregullta për punonjësit e Ministrisë

E gjetura

Ne identifikuam parregullsitë si në vijim:

- Drejtori i Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës në Gjakovë vazhdon të punojë dhe paguhet nga MKRS edhe pse kontrata i ka skaduar që nga dhjetori 2013. Vlen të përmendet që të njëjtit i është lëshuar aktemrimi më datë 08.06.2018;
- Në katër⁴ raste punëtorët paguheshin sipas rregullores nr.05/2011 për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore edhe pse pozitat e tyre nuk figurojnë në këtë rregullore; dhe
- Nga shqyrtimi i listës së punonjësve të MKRS, kemi vërejtur se, në shumë raste ishin aplikuar kompensime me koeficient të ndryshëm për pozita të njëjta.⁵

Rreziku

Pagesat në mungesë të kontratave valide të punës si dhe pagesat për pozitat e punës të cilat nuk janë të parapara në rregullore, rrisin mundësinë e pagesave të parregullta për ministrinë. Po ashtu, mos harmonizimi i koeficienteve dhe pagesave të zyrtarëve për pozita të njëjta, ndikon në cilësinë e punëve të kryera nga zyrtarët përkatës.

Rekomandimi 7

Ministri duhet të shqyrtojë rastet e identikuara dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin do të bëhet konform kontratave valide dhe rregulloreve në fuqi.

⁴ Pozitat: Pastrues në pastrim kimik në Teatrin Kombëtar të Kosovës dhe dy Pastruese e një Shtëpiak/ vozitës, në Ansamblin e Këngëve dhe Valleve Shota

⁵ Pozita Asistent Administrativ – koeficientet 5, 6 dhe 7; pozita Ciceron – koeficientet 5, 6 dhe 7; pozita mirëmbajtës – koeficientet 4,5 dhe 6; pozita pastrues – koeficientet 4, 5 dhe me pagë fikse sipas rregullores për krijues dhe performues; punëtor sigurimi 5.5 dhe 6 dhe me pagë fikse sipas rregullores, pozita rekuiziter koeficienti 5 dhe me pagë fikse sipas rregullores; pozita rrobaqepës – koeficienti 6 dhe me pagë fikse sipas rregullores; pozita shofer – koeficientet 6 dhe 7.

Çështja 8 - Kategorizimi i drejtorëve në Institucionet vartëse të kulturës

- E gjetura** Drejtorët e Institucioneve vartëse të kulturës në listat e pagave, kategorizohen si shërbyes civilë me koeficient 9 ose 10, që do të thotë, janë ekuivalentë me pozitën udhëheqës divizioni apo udhëheqës departamenti në nivel të ministrive, përderisa zgjidhen me mandat katër vjeçar nga një trup të emëruar nga Ministri siç është Këshilli Drejtues. Ligji për Shërbimin Civil 03/L-149, këto pozita i cilëson si pozita të karrierës dhe ato nuk kanë mandat fare.
- Rreziku** Kategorizimi si shërbyes civil i pozitave të drejtorëve që janë të emëruar me mandat katër vjeçar mund të krijojë paqartësi në linjat e raportimit, ndikojë në cilësinë e punëve të kryera dhe në arritjen e objektivave të Institucionit Vartës.
- Rekomandimi 8** Ministri duhet të sigurojë se kategorizimi i pozitave të Drejtorëve në Institucionet Vartëse të bëhet në përputhje me mandatin e tyre dhe me ligjet përkatëse të institucioneve vartëse.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me, rekrutimin, kontratat, trajnimet, avancimin, pushimet etj. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarrura në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet e bëra kanë rezultuar çështjet në vijim:

Çështja 9 - Procedurat e rekrutimit

- E gjetura** MKRS gjatë vitit kishte angazhuar 104 persona me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (MSHV). Në bazë të ligjit për shërbimin civil të Kosovës, këto i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për to duhet të zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit. Ne kemi vërejtur se nga 104 të angazhuarit me MSHV, 14 prej tyre janë marrë pa procedura të rekrutimit.
- Rreziku** Angazhimi i punëtorëve me MSHV pa procedura adekuate të rekrutimit, rrit rrezikun që të angazhohen personat jo kompetent për pozitën përkatëse dhe kjo mund të rezultojë në mos efikasitet operacional dhe mosarritje të objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 9** Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta angazhohen me procedura rekrutuese sipas kërkesave ligjore.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2017 ishte 2,001,875€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,797,364€. Ato kanë të bëjnë me furnizime me material harxhues, mirëmbajtje, shërbime kontraktuale si dhe shërbime komunale.

Çështja 10 - Pagesa të parregullta

E gjetura

Nga testimet tona identifikuam parregullsitë si në vijim:

- Me vendim të Sekretarit ishte paguar komisioni për “çështje banesore” i përbërë prej pesë anëtarësh, zyrtarë të ministrisë për mbajtjen e gjashtë seancave, në vlerë totale 3,125€. Vendimi dhe pagesa ishin në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë i cili specifikon se nëse një punonjës, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim; dhe
- Bazuar në Ligjin Nr.02-L-088 për Trashëgiminë Kulturore, MKRS mund të mbulojë vetëm shpenzimet e restaurimit dhe ato të konservimit për objektet e trashëgimisë kulturore në pronësi private. MKRS kishte nënshkruar kontratë në vlerë 9,560€ për “Furnizim me lëndë djegëse-pelet për Rezidencën Ibrahim Rugova”. Malli dhe fatura janë pranuar në vlerë totale, mirëpo në mungesë të mjeteve ishin paguar vetëm 1,510€.

Rreziku

Kompensimi shtesë për shërbimet që janë pjesë e detyrave të obligueshme të postit që mbajnë punonjësit e ministrisë dhe mbulimi i shpenzimeve në mungesë të bazës ligjore rezulton me pagesa të parregullta për ministrinë.

Rekomandimi 10

Ministri duhet të siguroj se nuk do të ketë kompensime shtesë për shërbimet që janë pjesë e detyrave të obligueshme të postit që mbajnë punonjësit e ministrisë. Gjithashtu duhet të siguroj se të gjitha pagesat kryhen sipas ligjeve përkatëse.

Çështja 11 – Parregullsi në procedura të prokurimit si dhe mangësi nga komisionet e pranimi të mallit**E gjetura**

Nga testimet tona identifikua parregullsitë si në vijim:

- MKRS në planin e prokurimit për vitin 2017 kishte paraparë që mallrat dhe shërbimet ti kryej me kontrata me vlerë të vogël dhe të mesme. Ministria kishte aplikuar kontrata me vlerë minimale, duke u furnizuar disa here gjate vitit për të njëjtit artikuj si 11 herë me pajisje të teknologjisë informative, katër herë me inventar dhe tre herë për servisim të automjeteve. Për më tepër, kërkesat për mallrat dhe shërbime të bëra nga njësia kërkuese nuk përputhen me sasinë e furnizimit; dhe
- Komisionet për pranimin e mallit nuk ishin të autorizuara, siç kërkon rregulla 01/2013 për shpenzimin e parasë publike. Poashtu, këto komisione që pranuan mallrat kishin raporte të mangëta, të cilat nuk dëshmojnë se janë pranuar mallrat e paguara, pasi që nuk specifikojnë llojin, sasinë e mallrave të pranuar si dhe kontratën për të cilën janë paguar.

Rreziku

Kontraktimi i shërbimeve në mospërputhje me planin dhe aplikimi i disa kontratave për të njëjtin mall/shërbim nuk janë efikase dhe mund të shkaktojnë shpenzime shtesë për ministrinë. Po ashtu, komisionet e paautorizuara dhe raportet e mangëta të pranimi të mallit janë në kundërshtim me rregullat dhe rrezikojnë që mallrat të mos pranohen sipas sasisë dhe cilësisë së kontraktuar.

Rekomandimi 11

Ministri duhet të siguroj që plani i prokurimit të përfshijë në një kontratë mallrat, shërbimet si dhe furnizimet e njëjta. Për çdo furnizim, komisionet të autorizohen dhe raportet e pranimi të përmbajnë informatat e nevojshme që dëshmojnë se mallrat e paguara janë pranuar në përputhje me sasinë dhe cilësinë e kontratës përkatëse.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 8,723,413€. Prej tyre në vitin 2017 ishin shpenzuar 8,583,046€. Ministria përveç që ndan subvencione për të financuar aktivitetet bazë të Institucioneve vartëse, ajo mbështetë edhe financimin e projekteve të ndryshme kulturore, sportive, të rinisë dhe të trashëgimisë kulturore.

Çështja 12 - Subvencionim i parregullt

E gjetura MKRS kishte mbuluar shpenzimet për fanellat e tifozëve “Dardanët” me rastin e garave kualifikuese “Botërori Rusi 2018”, në total prej 23,570€. Sipas rregullores së brendshme për subvencione dhe transfere, për vlerat e subvencionuara mbi 10,000€ duhet të merret miratimi edhe i Ministrit. Në rastin konkret kjo nuk ishte bërë, dhe se për të njëjtin aktivitet ishin bërë tri pagesa për subvencionim, derisa kontrata me përfituesin e subvencionit është nënshkruar pas pranimit të faturës për pagesë.

Rreziku Ndarja e vendimeve për subvencionimin e të njëjtit aktivitet duke anashkaluar aprovimin e subvencionit nga Ministri, rrit rrezikun që pagesat më vlera të larta të mos kenë mbikëqyrje të mjaftueshme dhe se kjo mund të ndikoj në mos arritjen e objektivave.

Rekomandimi 12 Ministri duhet të siguroj që secili vendim për subvencionim do të përmbajë shumën totale të financuar për aktivitetin e caktuar dhe do të jetë konform rregullores së brendshme.

Çështja 13 - Arsyetim i dobët i shpenzimeve nga federatat

E gjetura Nga testimet tona identifikuam parregullsitë si në vijim:

- Subvencionet e dhëna për 10 federata sportive⁶ me vlerë totale 381,000€ nuk ishin menaxhuar mirë, kjo ngase në 13 raste mjetet e kështit përkatës ishin derdhur pa u arsyetuar tërësisht kësti paraprak, siç kërkohet me nenin 20 të rregullores së brendshme për subvencione;
- Në dy raste tjera të financimit të federatave sportive⁷ dhe komitetit olimpiq ishin bërë pagesa edhe pse të njëjtat nuk kishin dorëzuar projektin financiar siç kërkohet me nenin 17 të rregullores së brendshme për subvencione; dhe

⁶ Federata e Atletikës, PingPongut, Shahut, Notit, Tenisit dhe Kick-boxit, Futbollit, Basketbollit, Shigjetarise, Autosporteve

⁷ 4 Federata e auto-sporteve dhe Federata bjeshkatore alpiniste e Kosovës

- Për mbështetjen e tri federatave sportive⁸ në vlerë 78,421€, vendimi për subvencionim, ishte bërë pas përfundimit të projektit. Edhe pse subvencionimi ishte bërë pas realizimit të aktivitetit, tek projektet e dy federatave të para, nuk kishte arsytetime të shpenzimeve me rastin e përkrahjes së projektit.

Rreziku

Mungesa e arsytimit të subvencioneve dhe dhënia e tyre duke mos i respektuar kriteret e rregullores së brendshme mund të ndikojë në mosarritjen e objektivave të Ministrisë, dhe rrit rrezikun që fondet të përdoren për qëllime tjera nga ato të planifikuarat. Dhënia e subvencioneve pas realizimit të projektit është në kundërshtim me rregullat, ndikon në menaxhim jo të mirë të buxhetit dhe mund të shkaktojë keqpërdorimin e fondeve.

Rekomandimi 13 Ministri duhet të sigurohet që respektohen të gjitha kriteret e rregullores së brendshme me rastin e financimit të Federatave dhe të mos financohet kësti tjetër pa u arsyetuar tërësisht këstet paraprake. Gjithashtu të siguroj se, vendimet për dhënien e subvencioneve do të merren para realizimit të projekteve dhe mos të jepen subvencione për projektet që tashmë janë realizuar.

Çështja 14 - Shpenzim i mjeteve nga institucionet vartëse të ministrisë**E gjetura**

Nga testimet tona identifikuam parregullsitë si në vijim:

- Tek subvencionimi i Baletit nga MKRS në vlerë 39,560€, vërejtëm se Baleti i Kosovës nuk ka një rregullore që përcakton tarifën e pagesës së stafit të brendshëm të angazhuar në projekte, ndërkaq koreografet e jashtëm të angazhuar në projekte, janë paguar me para në dorë. Më tej, për pagesat e honorarëve të punëtorëve të rregullt nuk janë mbajtur në burim kontributet dhe tatimi në pagë, ashtu siç kërkohet me Ligjin e të Ardhurave Personale. Po ashtu, mëditjet për udhëtime zyrtare paguhen në tarifë fikse prej 40€, duke mos respektuar udhëzimin administrativ nr.2004/07 për udhëtime zyrtare. Për më tepër, të gjitha kontratat për furnizime në lidhje me këtë projekt ishin bërë në mungesë të procedurave për përzgjedhjen e kompanive;

⁸ Federata e Boullingut, Federata e Karatës dhe Federata e PingPongut

- Me rastin e subvencionimit të Filarmonisë së Kosovës, kemi vërejtur se mungon raporti narrativ dhe dokumentet financiare mbështetëse nuk janë në pajtim me Rregullën nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike. Kjo pasi që shtatë dirigjent të huaj të angazhuar në projekte ishin paguar me para në dorë në vlerë 29,787€, me para në dorë ishin paguar edhe 58 instrumentist të huaj në vlerë 15,000€ si dhe tetë solist të huaj në vlerë 3,750€. Më tutje, në shtatë raste për shërbimet e transportit për në Shqipëri në vlerë 4,200€ dhe në gjashtë raste të qiramarrjes së instrumenteve në vlerë 4,300€ nuk ishin aplikuar procedura për përzgjedhjen e kompanive. Nuk kishte kontrata me kompanitë përkatëse, ashtu siç kërkohet me rregulloren e brendshme për subvencione dhe pagesat për këto shërbime ishin bërë me para në dorë. Procedurat për përzgjedhjen e kompanive nuk ishin aplikuar edhe në kontraktimin e furnizimeve dhe shërbimeve tjera si, akomodim, shërbime për mbajtjen e koncerteve, e të ngjashme; dhe
- Tek subvencionimi i shfaqjes “Zoti i masakrës” në vlerë 10,000€, Teatri i Kosovës nuk kishte mbajtur në burim kontributet për të angazhuarit e brendshëm, ndërkaq për aktorët jo vendas nuk kishte ndalur tatimet.

Rreziku

Mangësitë në menaxhimin e proceseve dhe të shpenzimeve të institucioneve vartëse si dhe mungesa e rregulloreve/udhëzimeve për pagesën e punëtorëve, zvogëlojnë efikasitetin dhe rrezikojnë arritjen e objektivave të projekteve të caktuara dhe të ministrisë në përgjithësi.. Më tutje, pagesat me para në dorë dhe furnizimet në mungesë të procedurave, rrezikojnë parimin e shfrytëzimit efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve publike dhe mund të shkaktojnë pagesa të parregullta.

Rekomandimi 14 Ministri duhet që të hartojë rregullore gjithëpërfshirëse për kompensimin e të angazhuarve në projektet e Baletit, dhe se , kompensimi për të angazhuarit e jashtëm të bëhet vetëm përmes llogarisë bankare. Po ashtu tatimet dhe kontributet e të angazhuarve duhet të mbahen në burim sipas kërkesave ligjore si dhe furnizimet nga institucionet vartëse duhet ti nënshtrohen procedurave formale të prokurimit.

Çështja 15 – Subvencionim i ngjarjeve me karakter biznesi

- E gjetura** MKRS kishte mbështetur projektin “Koleksioni Dardania” në vlerë 6,000€. Në mungesë të planit dhe arsyeshmërisë së projektit, mjetet për këtë projekt ishin derdhur në llogari private dhe nuk dihet qëllimi i subvencionimit pasi që aktiviteti i realizuar kishte karakter biznesi. Kjo ishte në kundërshtim me rregulloren e brendshme të subvencioneve, e cila i specifikon subjektet që MKRS ka të drejtë t’i subvencionojë.
- Rreziku** Financimi i ngjarjeve që janë në kundërshtim me rregulloren e brendshme të subvencioneve dhe derdhja e mjeteve në llogari private mund të rezultojë me keqpërdorim eventual të mjeteve dhe mosarritjen e objektivave të Ministrisë.
- Rekomandimi 15** Ministri duhet të siguroj se përkrahen vetëm projektet dhe aktivitetet e subjekteve që janë në përputhje të plotë me kriteret e rregullores se brendshme të subvencioneve.

Çështja 16 - Vonesa në arsyetimin e subvencioneve

- E gjetura** Sipas marrëveshjeve të nënshkruara me rastin e dhënies së subvencioneve për projekte të ndryshme, bartësit e projekteve obligohen që t’i arsyetojnë shpenzimet e realizuara, në afat prej 30 ditësh pas realizimit të aktiviteteve të subvencionuara. Ne konstatuam se në 15 raste me vlerë 124,345€, subvencionet nuk ishin arsyetuar edhe pse aktivitetet e subvencionuara kishin kohë që kishin përfunduar. Për subvencionet e pa mbyllura të viteve të mëhershme (para vitit 2015), MKRS ka nisur procedurat gjyqësore për kthimin e mjeteve.
- Rreziku** Mungesa e arsyetimit të subvencioneve mund të ndikoj në mosarritjen e objektivave të Ministrisë, dhe rrit rrezikun që fondet të përdoren për qëllime tjera nga ato të planifikuarat.
- Rekomandimi 16** Ministri duhet të sigurohet që monitorimi nga zyrtarët të jetë i rregullt për subvencionet e dhëna dhe të respektohen afatet ligjore për raportimin e shpenzimeve të shfrytëzuara nga përfituesit e projektit.

Çështja 17 – Financimi i OJQ-ve

- E gjetura** Në një rast të subvencionit në vlerë 2,000€, pagesa është bërë në llogari private të personit dhe jo të OJQ-së. Tek e njëjta, nuk kishte kontratë të nënshkruar me përfituesin dhe kërkesa për financim të pjesëmarrjes në turnirin ndërkombëtar të veteranëve të futbollit në Turqi, e bërë në emër të OJQ “Veteranet e futbollit të Prizrenit” ishte e pa nënshkruar nga OJQ.
- Rreziku** Derdhja e mjeteve në llogari të bizneseve apo në llogari private të personave është kundërshtim me rregullat dhe mund të rezultojë me keqpërdorim eventual të mjeteve. Mungesa e kërkesës valide dhe kontratës me përfituesin mund të rezultojë në mosarritje të qëllimit të subvencionit.
- Rekomandimi 17** Ministri duhet të sigurohet që në të ardhmen mjetet për financimin e projekteve të OJQ-ve të derdhen në llogaritë bankare të OJQ-ve (personave juridik) që subvencionohen. Të sigurohet gjithashtu se OJQ-të financohen vetëm në rast të kërkesave valide dhe të kenë kontratë të nënshkruar me përfituesin e subvencionit.

Çështja 18 - Pagesat nga subvencionet për kategori të tjera të shpenzimeve

- E gjetura** Në katër raste në vlerë totale 1,350€, nga subvencionet dhe transferet ishin kompensuar anëtarët e këshillave drejtues të institucioneve vartëse dhe anëtarët e këshillave dhe komisioneve tjera të ndryshme.
- Rreziku** Pagesat nga buxheti i subvencioneve për kategori tjera të shpenzimeve shkaktojnë menaxhim të dobët buxhetor dhe raportim të gabueshëm financiar. E gjithë kjo rezulton në përdorimin e fondeve në kundërshtim me synimet e planifikuara dhe keq klasifikim të shpenzimeve në PF.
- Rekomandimi 18** Ministri duhet të vendos kontrole buxhetore më të forta dhe të sigurojë që shpenzimet bëhen në përputhje me qëllimin dhe planifikimin e tyre në mënyrë që të sigurohet shpenzim adekuat i buxhetit dhe klasifikim i duhur i shpenzimeve.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,472,862€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 9,953,762€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e palestrave sportive, qendrave kulturore, rinore dhe gërmimeve arkeologjike. Nga testimi i mostrave rezultuan parregullsitë si në vijim:

Çështja 19 - Shpenzime të pa rregullta dhe mos ndjekje e procedurave të prokurimit

E gjetura MKRS nuk kishte ndjekur procedura të prokurimit në kontraktimin e Projekt Menaxherit Mbikëqyrës për kryerjen e shërbimeve profesionale “Renovimi i Stadiumit të Qytetit të Prishtinës”. Më tutje, për të njëjtin nuk ishin mbajtur në burim kontributet dhe tatimi në pagë, ashtu siç kërkohet nga Ligjin e të Ardhurave Personale. Gjatë vitit 2017, pagesat totale për shërbimet e mbikëqyrëse të këtij menaxheri të projektit ishin 49,500€.

Rreziku Kontraktimi i shërbimeve duke shmangur procedurat e prokurimit, rrezikon parimin e shfrytëzimit efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve e burimeve publike. Ndalja në burim e kontributeve dhe tatimit në pagë janë një detyrim ligjor për secilin punëdhënës dhe mund të rrezikoj që MKRS të jetë subjekt i ndëshkimeve nga autoritetet tatimore.

Rekomandimi 19 Ministri duhet të siguroj se për secilin aktivitet të përkufizuar në LPP, do të aplikohen procedurat e prokurimit. Po ashtu, duhet të siguroj që kontrollet lidhur me shpenzimin e parasë publike janë duke funksionuar, ashtu që pagesat të realizohen në përputhje të plotë me ligjet në fuqi.

Çështja 20 - Përzgjedhja e OE të pa përgjegjshëm

E gjetura Në katër⁹ raste, MKRS kishte shpërblyer me kontratë OE të cilët nuk i kishin plotësuar të gjitha kriteret sipas dosjes së tenderit. OE fitues vetëm pjesërisht kishin dëshmuar pronësinë e makinerisë së listuar dhe mjeteve të punës të nevojshme për realizimin e punëve.

Rreziku Përzgjedhja e OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kriteret, ndikon në zvogëlimin e besueshmërisë së procesit dhe mund të rezultojë me shërbime jo cilësore nga mungesa e makinerisë dhe mjeteve të punës, po ashtu mund të ketë edhe vonesa në realizimin e kontratës.

Rekomandimi 20 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kontratat lidhen me OE të cilët i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

⁹ “Renovimi i Stadiumit Olimpik Adem Jashari në Mitrovicë” - 1,997,393€, “Ndërtimi i palestrës sportive në Komunën e Deçanit-Faza e Tretë” - 549,865€, “Faza e dytë-Stadiumi Ndihmës-Boka, Prizren” - 339,438€ dhe “Rregullimi i fushës së futbollit me bari sintetik në stadiumin 2 Korriku, Prishtinë” - Vlera 181,750€

Çështja 21 – Lidhja e aneks kontratës në mënyrë të pa rregullt

E gjetura Duke ju referuar LPP, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës kur punët apo shërbimet e tilla, edhe pse të ndara nga ekzekutimi i kontratës origjinale, janë të domosdoshme për të kompletuar punët.

Në kuadër të kontratës bazë në vlerë prej 3,843,715€, "Renovimi i Stadiumit të Qytetit në Prishtinë", MKRS kishte lidhur një aneks kontratë për punë shtesë në vlerë prej 381,088€. Kjo ishte bërë me qëllim që stadiumi t'i arrijë standardet e kërkuara nga UEFA për kategorinë e IV të stadiumeve. Ky aneks ishte lidhur edhe pse dihej që me punët shtesë të parapara në këtë aneks, nuk do të arrihen ato standarde dhe se për këtë qëllim do të nënshkruhet një kontratë e re. Për më tepër, për të kompletuar të gjitha punimet e kërkuara nga UEFA për kategorinë e IV, MKRS ka lidhur kontratë me procedura të negociuara pa publikim të kontratës, në vlerë 4,471,928€.

Rreziku Procedurat e negociuara pa publikim, të aplikuar në kundërshtim me kushtet e parapara me LPP, mund të rrezikoj parimin e shfrytëzimit efikas, me kosto ekonomike, transparente dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike.

Rekomandimi 21 Ministri duhet të siguroj se procedurat e negociuara të prokurimit pa publikim të njoftimit të kontratës, aplikohen vetëm nën kushtet e parapara në LPP.

Çështja 22 – Realizim i dobët i planit të prokurimit për investime kapitale

E gjetura Në planin e prokurimit ishte paraparë nënshkrimi i 77 kontratave. Plani i prokurimit përfshinte edhe projektet të cilat janë transferuar në institucionet vartëse të MKRS (pa procedura prokurimi). Po ashtu, në këtë plan ishin të përfshira edhe projektet për të cilat procedurat e prokurimit i ka zhvilluar komuna. Kjo kishte ndodhur pasi që gjatë vitit 2017, Ministri kishte marrë vendim që për 57 projekte, të bartë përgjegjësinë e zhvillimit të procedurave tek komunat. Përveç kësaj, MKRS ka nënshkruar pesë kontrata në vlerë prej 334,428€, të cilat nuk ishin të parapara në plan të prokurimit. Kjo kishte ndodhur pasi që në planin e prokurimit dhe në PIP këto ishin paraparë si një projekt i vetëm (psh. Renovimi i Palestrave Ekzistuese në Qendrat Regionale).

Rreziku Mos realizimi i planit të prokurimit për projektet e rëndësishme kapitale që ishin parapara dhe diferencat e theksuara mes planifikimit dhe realizimit të projekteve kapitale, rrisin rrezikun që të mos arrihen objektivat e përcaktuara të Ministrisë.

Rekomandimi 22 Ministri duhet të siguroj që përgatitjes së planit të prokurimit t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e tij në mënyrë që mos të ketë devijime të theksuara në mes të kontratave të realizuara në raport me ato të planifikuara.

3.8 Çështjet e përbashkëta për të gjitha kategoritë

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me subvencionet dhe transferet si dhe investimet kapitale:

Çështja 23 – Nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit

E gjetura Sipas rregullores 02/11 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, është në përgjegjësi të Ministrit nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit/bashkëpunimit në emër të institucionit. Ne vërejtëm se në vitin 2017, të gjitha marrëveshjet e tilla ishin nënshkruar nga ana Sekretarit të Përgjithshëm (SP).

Rreziku Nënshkrimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit/bashkëpunimit nga Sekretari, është në kundërshtim me rregulloren dhe rrezikon që shpenzimi i parasë publike të mos jetë në përputhje me politikat e caktuara të ministrisë.

Rekomandimi 23 Ministri duhet të sigurojë që të gjitha marrëveshjet e mirëkuptimit/bashkëpunimit nënshkruhen nga ai dhe jo nga SP, apo në të kundërtën të autorizojë SP për bartjen e kësaj përgjegjësie.

Çështja 24 - Mos deklarim i blerjeve mbi 500€ në ATK

E gjetura MKRS gjatë vitit 2017 nuk kishte deklaruar për blerjet mbi 500€ në ATK, edhe pse kjo është kërkesë e Ligjit Nr.03-L–222 për Administratën Tatimore dhe procedurat (neni 47 pika 3). Përveç që është kërkesë ligjore, MKRS e ka të domosdoshëm këtë deklarim, marrë parasysh faktin se Institucionet vartëse të MKRS, për disa nga blerjet aplikojnë formën e pagesave me para në dorë.

Rreziku Mos deklarimi i blerjeve sipas kërkesave ligjore e ekspozon MKRS ndaj rrezikut të pagesës së faturave fiktive dhe njëkohësisht të jetë objekt i masave ndëshkuese të parapara me Legjislacionin Tatimor të Kosovës. E gjithë kjo, mund të shkaktojë dëmtim të buxhetit dhe arritjen e objektivave të ministrisë.

Rekomandimi 24 Ministri duhet të sigurojë se MKRS do të respektojë kërkesën ligjore sa i përket deklarimeve në ATK, në mënyrë që të shmangët mundësia e pagesave të faturave fiktive, apo ajo e ndëshkimeve të mundshme.

Çështja 25 – Pagesat përmes thesarit dhe vendimeve gjyqësore

E gjetura MKRS kishte shpenzime në vlerë 689,571€, në bazë të nenit 40 - vendimeve gjyqësore dhe të nenit 39.2 për përmbaruesit privat. Thesari kishte ekzekutuar pagesat që ishin borxhe të MKRS ndaj operatorëve ekonomik, kryesisht për arsye të mungesës së mjeteve buxhetore. Arsyeja tjetër e numrit të madh të pagesave të kësaj natyre, qëndron në faktin e mungesës së një procedure të qartë për pranimin dhe evidentimin e faturave në nivel të Ministrisë, pasi që të njëjtat pranohen të shpërndara në institucionet vartëse të saj, me ç’rast shkaktohen vonesa në mbledhjen dhe pagesën e tyre nga MKRS. Edhe pse faturat ishin të pa protokolluara dhe në disa raste MKRS kundërshtonte disa pagesa si të pabazuara, Thesari kishte bërë ekzekutimin e tyre bazuar në datën e vendosur nga OE.

Rreziku Mos zbatimi i procedurave të kontrollit të brendshëm me rastin e pranimin të faturave, mund të rezultoj me humbje të faturave dhe rrjedhimisht MKRS nuk do të ketë informacionin e duhur dhe në kohë lidhur me obligimet paraprake. Kjo shpie në akumulimin e borxheve të vjetra, si dhe rrezikon MKRS që të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore. Po ashtu, pagesat e bëra nga Thesari, pa zbatuar saktësisht kërkesat e nenit 39,2 mund të rrezikojnë që të paguhen mallrat dhe shërbimet e papranuara.

Rekomandimi 25 Ministri dhe Drejtori i Thesarit duhet të sigurojnë që të mos paguhen fatura të papranuara/pa protokolluara nga MKRS dhe pa u konfirmuar marrja e mallrave apo shërbimeve.

3.9 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale mbi 1,000€ në MKRS ishte 23,287,695€. Pjesa dërmuese e këtyre pasurive (99%) apo pasuri në vlerë prej 23,061,300€ janë të paraqitura si investime në vijim. Ndërsa vlera e pasurisë nën 1,000€ e prezantuar në PFV ishte 314,290€.

Për më gjerësisht, referojuni kapitullit 2.1(Theksimi i çështjes).

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të MKRS në 2017 ishin në vlerë 3,500€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat e pa inkasuara nga qiraja e Agjencionit të Arkivave të Kosovës, i cili është nën menaxhimin e MKRS nga viti 2017.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 2,262,000€, që ishte pothuajse njëjtë me vitin paraprak. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Ndërsa vlera e detyrimeve kontingjente e prezantuar në PFV ishte 157,000€.

Çështja 26 - Raportim jo i plotë dhe dobësi në menaxhimin e obligimeve

- E gjetura** Nga faturat e paguara në vitin 2018 (periudha Janar-Mars) të cilat ishin obligime të vitit 2017, ne kemi konstatuar se 35 fatura në vlerë totale prej 80,598€, të paguara gjatë viti 2018 nuk ishin të prezantuara në raportin e obligimeve të viti 2017. Poashtu kishte tejkalim të afatit ligjor (30 ditë) për pagesën e obligimeve të prezantuara në PFV. Vonesa të tilla variojnë nga 2 deri në 591 ditë vonesë. Kjo ka ndodhur pasi që, MKRS nuk ka zbatuar procedurat e kontrollit të brendshëm me rastin e pranimit të faturave, ngase faturat e pranuar nuk protokollohen dhe evidentohen në librin e faturave ashtu siç kërkohet me Rregulloren Financiare 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike.
- Rreziku** Raporti jo i plotë i obligimeve të pa paguara, dhe tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund të rezultojë me humbje të faturave dhe rrjedhimisht MKRS nuk do të ketë informacionin e duhur dhe në kohë lidhur me obligimet paraprake, poashtu MKRS mund të jetë subjekt i ekzekutimeve direkte nga MF dhe vendimeve gjyqësore.
- Rekomandimi 26** Ministri duhet të siguroj se pagesa e faturave bëhet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara me rregullore, ndërsa ato që kanë kaluar afatin e pagesës të jenë të prezantuara drejtë në raportin e obligimeve. Është i nevojshëm të bëhet një plan ku parashihet buxheti dhe veprimet konkrete për shlyerjen graduale të borxheve të akumuluar.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

MKRS ka pranuar rekomandimet tona për auditimin e vitit 2016, në qershor 2017 dhe një plan veprimi, është përpiluar për zbatim të këtyre rekomandimeve.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, nga 22 rekomandimet e dhëna në vitin 2016, gjashtë rekomandime janë zbatuar, një është në proces dhe 15 nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe 16 rekomandime të cilat nuk ishin zbatuar edhe këtë vit. Përderisa nuk janë zbatuar rekomandimet e vitit 2016 dhe ato të viteve të mëhershme, mangësitë në sistemet domethënëse mbesin të pa trajtuara. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 27 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

E gjetura Për shkak të përpilimit me vonesë të planit të veprimit, menaxhimit të dobët të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Ne nuk kemi vërejtur se MKRS aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, si subvencione dhe transfere, investime kapitale dhe të tjera kanë rezultuar në:

- Mos-efikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe praktika jo të mira të qeverisjes;
- Pagesa në mungesë të raporteve të punës dhe mos realizim i projekteve kapitale;
- Mos aplikimi i rregullores për dhënien dhe arsyetimin e subvencioneve; dhe
- Pagesa të parregullta për mallrat dhe shërbimet.

Rekomandimi 27 Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm (AP), me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MKRS veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Aranzhimet tjera të cilat do ta mbështesnin zhvillimin e qeverisjes, si përgjigjja efektive ndaj rekomandimeve të auditimit nuk ishin vendosur plotësisht. Edhe pse komiteti i auditimit është i themeluar, nuk kishte vepruar për t'i siguruar NJAB-së pavarësinë e duhur të veprimit.

Edhe më tutje, mbetet sfidë monitorimi i institucioneve vartëse, të cilat edhe pse raportojnë në ministri, nuk kanë menaxhim të mirë financiar, dhe llogaritë e tyre bankare në bankat komerciale vazhdojnë të funksionojnë pa autorizim të thesarit. Kontrollet ishin të dobëta dhe në menaxhimin e shpenzimeve posaçërisht në subvencione dhe investime kapitale.

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës. MKRS në fund të vitit 2017 ka hartuar planin zhvillimor strategjik 2018-2021, mirëpo i njëjti ende nuk është miratuar në qeveri për tu konsideruar si i vendosur. Ministria nuk ka të vendosur as procedurat për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimi e rrezikut.

Sa i përket raportit të vetëvlerësimit, MKRS ka dorëzuar atë në Ministrinë e Financave në afatin e paraparë.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe një auditor. NjAB e kishte përfunduar tre nga pesë auditimet e planifikuara, si dhe kishte kryer katër auditime shtesë me kërkesë të menaxhmentit.

Çështja 28 - Mosfunksionim efektiv i Sistemit të Auditimit të Brendshëm

- E gjetura** Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si:
- Plani i auditimit nuk ishte gjithëpërfshirës, ngase nuk është mbuluar auditimi i institucioneve vartëse;
 - Drejtori i NjAB-ës raporton tek Sekretari i Përgjithshëm, përderisa me ligjin e AB dhe kornizën e qeverisjes së mirë kjo përbën konflikt interesi;
 - Menaxhmenti i njësive të audituara nuk kishte përgatitur plane të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB.
- Rreziku** Mos përfshirja e të gjitha institucioneve në aktivitetet e NjAB-së, pamundëson identifikimin dhe parandalimin e gabimeve dhe zvogëlon sigurinë që i ofrohet menaxhmentit në lidhje me efektivitetin e kontroleve kyçe financiare. Raportimi i Drejtorit të NjAB tek Sekretari i përgjithshëm rrezikon pavarësinë dhe objektivitetin e NjAB dhe mund të rezultojë me mos përmbushje të misionit të NjAB. Mos adresimi i rekomandimeve të NjAB nga ana e menaxhmentit mund të rezultojnë në përsëritjen e dobësive dhe me vazhdimin e praktikave joefektive që mund të përfundojnë me humbje financiare.
- Rekomandimi 28** Ministri duhet të siguroj aktivitetet të mjaftueshme të NjAB mbi institucionet vartëse të MKRS dhe përfundimin e planit vjetor të auditimit. Linjat llogaridhënëse brenda ministrisë duhet të rishikohen, në mënyrë që NjAB të raportojë tek Ministri. Poashtu duhet të ndërmerren veprime proaktive në adresimin e rekomandimeve të NjAB duke përgatitur një plan të veprimit për implementimin e tyre.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 29 - Dobësi në kontrollet menaxheriale dhe menaxhimin e rrezikut

E gjetura Departamentet e MKRS-së bëjnë raporte të rregullta javore, respektivisht tremujore për punën e tyre, por raportet nuk përmbajnë informata të plota të cilat sigurojnë menaxhmentin lidhur me të gjitha aktivitetet brenda organizatës dhe të njëjtat nuk shqyrtohen dhe konsiderohen nga menaxhmenti i lartë në mënyrë që të sigurohet llogaridhënie efektive. Format i aktual i raporteve të tyre përveç aktiviteve dhe shpenzimeve të ndodhura nuk ofron detaje të mjaftueshme dhe shpjegime rreth variancave në mes të shpenzimeve dhe buxhetit. Më tej, auditimi ka identifikuar shumë mangësi në menaxhimin e buxhetit nga institucionet vartëse përfshirë tërheqjen e parave nga banka, pagesat me para në dorë, që nënkupton se kontrollet menaxheriale kanë qenë të dobëta;

Më tutje, ministria nuk ka hartuar regjistër të rreziqeve sipas kërkesave të MFK-së. Menaxhmenti ka formuar një grup punues për të punuar në hartimin e regjistrit të rreziqeve, por ky grup punues ende nuk ka nxjerrë rezultate/veprime konkrete.

Rreziku Kërkesat e llogaridhënies dhe raportimi financiar i cilësisë së dobët, mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut reduktojnë efektivitetin e menaxhimit financiar brenda MKRS, duke rezultuar me dobësi në procesin buxhetor si dhe në reduktimin e mundësisë që menaxhmenti të reagojë ndaj sfidave financiare me kohë. Po ashtu, kjo ulë efektin e kontrolleve buxhetore dhe rrit rrezikun për shpenzime të parregullta. Rrjedhimisht, kjo mund të rezultojë edhe me ofrimin e shërbimeve jo cilësore.

Rekomandimi 29 Ministri duhet të sigurojë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të llogaridhënies dhe të kërkesave për raportim të vendosura për institucionet vartëse dhe të zbatojë aranzhime më të mira për arritjen e objektivave të specifikuar brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Gjithashtu, për të reduktuar ndikimin e rreziqeve në nivele të pranueshme, MKRS duhet të hartoj regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat/veprimet e duhura për të vendosur nën kontroll kërcënimet e ekspozuara.

Çështja 30 - Mos-harmonizim i ligjeve dhe bartja e përgjegjësisë pa mbështetje ligjore**E gjetura**

Ligjet organike me të cilat rregullohet veprimtaria e Institucioneve vartëse të kulturës në MKRS janë të vjetra dhe të pa ndryshuara asnjëherë, si të tilla në shumë raste janë në konflikt me ligjet e përgjithshme mbi bazën e të cilave duhet të funksionojë ministria. Drejtorët e këtyre institucioneve raportojnë në departamentin e kulturës edhe pse Ligji për Administratën Shtetërore, Rregullorja për Standardet e Organizimit të Administratës Shtetërore dhe Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MKRS, e përcaktojnë shumë qartë se të vetmet njësi organizative që departamentet mund t'i kenë në vartësi, janë divizionet e përafërta.

Ndërsa, sa i përket kornizës ligjore të institucioneve të trashëgimisë kulturore, ato nuk janë të rregulluara me ligje të veçanta organike, dhe raportojnë tek Departamenti i Trashëgimisë Kulturore në MKRS. Veprimtarinë e tyre e bazojnë në ligjin për trashëgiminë kulturore (përveç Muzeut të Kosovës, i cili bazohet në ligjin për institucionet e kulturës). Në bazë të këtij rregullimi, këto institucione nuk kanë të drejtë të kenë kode buxhetore dhe të menaxhojnë me buxhetin e tyre, mirëpo këto duhet të kryhen nga ana e ministrisë. Ndërkaq, ne kemi vërejtur se këto institucione bëjnë shpenzime duke në kundërshtim me rregullimin ligjor ekzistues të tyre.

Rreziku

Mos-harmonizimi i ligjeve organike me ligjet e përgjithshme rezulton me probleme në menaxhimin e punës së institucioneve vartëse dhe rrezikon efektivitetin e menaxhimit administrativ dhe financiar si dhe krijon paqartësi në linjat e raportimit. Poashtu, bartja e përgjegjësisë për menaxhim dhe shpenzim të buxhetit tek institucionet e trashëgimisë kulturore mund të rezultojë në shmangie të kontrolleve të brendshme dhe shpenzimeve të parregullta.

Rekomandimi 30

Ministri duhet të inicioj menjëherë procedurat për harmonizimin e legjislacionit organik të institucioneve vartëse me legjislacionin e përgjithshëm për organizimin e administratës dhe për menaxhimin e financave publike. Po ashtu menaxhimi dhe shpenzimi i buxhetit të institucioneve të trashëgimisë kulturore duhet të bëhet nga departamentet përkatëse në ministri.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.4.Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Ministri duhet t'i analizojë arsyet për Kualifikim të Opinionit dhe Theksimin e Çështjes në 2015 dhe t'i identifikojë veprimet që kërkohen për të mundësuar prezantim të drejtë dhe të vërtetë të shpenzimeve dhe pasurisë në 2016.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementim e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Barrierat që pengojnë implementimin e rekomandimeve duhet të raportohen te Ministri dhe të përcaktohen dhe ndërmerren masat e nevojshme për adresimin e tyre.			Rekomandim i pazbatuar, pasi që nuk janë marrë masa, për implementimin e rekomandimeve në përgjithësi.
2.5.1 Aranzhimet e llogaridhënies	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të kërkesave ekzistuese të llogaridhënies dhe të raportimit të vendosura ndaj institucioneve vartëse si dhe të siguroj aranzhime të përmirësuara për të arritur objektivat specifike.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017

2.5.2 Menaxhimi i rrezikut	Ministri duhet të marrë në konsideratë zhvillimin e një qasje të re të menaxhimit e cila do të adresonte rreziqet potenciale që mund të pengojnë arritjen e objektivave të Ministrisë. Hartimi i një regjistri të rreziqeve potenciale do të ishte hap i parë për tu pasuar më tej me veprimet e nevojshme për menaxhimin/zbutjen e këtyre rreziqeve potenciale.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017
2.5.3 Raportimi Menaxherial	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2016.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017
2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet ti kushtoj rëndësi më të madhe sistemit të auditimit të brendshëm duke ju ofruar përkrahje të vazhdueshme dhe të nevojshme për punë efektive. KA duhet të rishikojë në mënyrë më kritike planet e NjAB (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe i ofrojnë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe zbatimin e planeve të veprimit.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017
3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që bëhen analiza të vazhdueshme mbi rrjedhën e realizimit të buxhetit në mënyrë që shpenzimet të bëhen në përputhje me planin buxhetor dhe me qëllim të shmangjes së parregullësive eventuale si rezultat i devijimeve nga plani. Gjatë planifikimit të investimeve kapitale duhet të mirren parasysh edhe faktorët e jashtëm ndikues.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet që të shqyrtoje rastet e identifikuara dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin e MKRS bëhet konform buxhetit të paraparë dhe në përputhje me kontratat e tyre. Puna jashtë orarit duhet të paguhet në pajtim me normat ligjore dhe vetëm pasi që kërkesa për punë të tillë të jetë aprovuar dhe dëshmuar në formë të dokumentuar.			Rekomandimi nuk është zbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.
3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Këto angazhime duhet të zhvillohen konform ligjit mbi detyrimet. Angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se 6 muaj, dhe pagesa e tyre duhet të bëhet nga mallrat dhe shërbimet. Derisa pozitat e karrierës duhet të mbulohen me punonjës të rregullt konform ligjit për shërbimin civil, në bazë të procedurave të rregullta të konkursit publik.			Rekomandimi i zbatuar pjesërisht pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë që me rastin e dhënies së subvencioneve të respektohen rregullat dhe kriteret, dhe të mos jepen subvencione të cilat nuk janë në harmoni me planin dhe natyrën e punës së Ministrisë.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë që realizimi i projekteve të subvencionuara të monitorohet në vazhdimësi për të siguruar respektimin e marrëveshjeve dhe raportimin për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Kjo do të siguronte që qëllimet e synuara me rastin e dhënies së subvencioneve janë arritur.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të siguroj që projektet e subvencionuara të jenë subjekt i monitorimit të rregullt nga zyrtarët e Ministrisë, për të siguruar respektimin e kërkesave/afateve për raportim nga përfituesit për mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve. Aty ku nuk respektohen kërkesat dhe afatet kohore për arsyetimin e shpenzimeve duhet të ndërmerren masat e nevojshme ndëshkuese.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të sigurojë që realizimi i projekteve të OJQ-ve që financohen nga Ministria të monitorohet në baza të rregullta për të siguruar se qëllimet e synuara janë arritur dhe shpenzimet janë arsyetuar me dëshmi relevante.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të punojë ngushtë me këshillat drejtues të institucioneve vartëse me qëllim që të hartojnë një rregullore gjithëpërfshirëse për angazhimin dhe pagesën e stafit për projekte të ndryshme, e cila në mënyrë të qartë do të përcaktojë procedurën e angazhimit dhe të kompensimit. Duhet të zbatohen kontrole të përmirësuara për të siguruar që të gjitha kompensimet e të angazhuarve të jashtëm të jenë të dokumentuara dhe të bëhen përmes llogarisë bankare.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.
3.5.2 Subvencionet dhe Transferet	Ministri duhet të vendos kontrole buxhetore më të forta dhe të sigurojë që shpenzimet bëhen në përputhje me qëllimin dhe planifikimin e tyre në mënyrë që të sigurohet shpenzim adekuat i buxhetit dhe klasifikim i duhur i shpenzimeve.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta

3.7.2 Trajtimi i borxheve	Ministri duhet të sigurojë që të bëj një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, të bëj një vlerësim të menjëhershëm të borxheve dhe të marrë masa adekuate për përmirësim të gjendjes aktuale.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta
Komponenta e auditimit	Rekomandimet nga viti 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.1 Opinioni i auditimit	Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikimin e opinionit dhe Theksimin të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në keq klasifikime, për t'i evituar pagesat e parregullta dhe për të bërë vlerësimin e saktë të pasurive kapitale			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe këtë vit janë përsëritur të gjeturat e njëjta.
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Ministri duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat ku janë identifikuar gabime. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Rekomandimi është zbatuar, pasi që PFV-të e 2017, nuk kanë rezultuar me gabime.		

2.1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm (AP), me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të Rëndësishme.			Rekomandim i pazbatuar, pasi që nuk janë marrë masa, për implementimin e rekomandimeve në përgjithësi.
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Ministri duhet të sigurojë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësorit të vet-vlerësimit, dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Rekomandimi është zbatuar.		
2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	Ministri duhet të iniciojë hartimin e strategjisë së përgjithshme të institucionit si dhe të hartoj planin e veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.		Rekomandimi është në proces të zbatimit, pasi që strategjia është hartuar, mirëpo ende nuk është e miratuar në qeveri.	
2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim, për të caktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të formës aktuale të raportimit dhe llogaridhënies së institucioneve për të vlerësuar dobësitë dhe për të përcaktuar aranzhime të përmirësuara. Përveç kësaj Ministri duhet të diskutojë me Ministrinë e Financave dhe Thesarin si dhe me Krerët e Institucioneve vartëse të MKRS-së për të gjetur alternativa më të përshtatshme të menaxhimit të mjeteve financiare të Buxhetit, përfshirë mundësinë që llogaritë aktuale bankare të autorizohen nga Thesari.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm (për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit) dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017
3.1. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që përgatitjes së kërkesave buxhetore t'i paraprijë një analizë e mirëfilltë e të gjithë faktorëve që kanë ndikim në realizimin e buxhetit. Përveç kësaj duhet të përmirësohet menaxhimi i projekteve kapitale për tu siguruar se ato përfundohen sipas afateve të kontraktuara dhe me cilësi optimale. Poashtu duhet të sigurohet që shpenzimet të realizohen konform kodeve adekuate ekonomike, në mënyrë që raportimi i tyre në PFV të jetë i drejtë dhe i saktë.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017

3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për shërbime të veçanta të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike. Këto angazhime duhet të zhvillohen konform dispozitave ligjore.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të shqyrtojë rastet e identifikuara dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar se kompensimi i pagave për stafin bëhet konform rregulloreve në fuqi.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të inicioj një rishikim të zbatimit të kontratës për riparimin e automjeteve, për të përcaktuar shkaqet e ndodhjes së lëshimeve. Njëherit duhet të shtohen kontrollet menaxheriale, për tu siguruar se veturat vërtet riparohen dhe se faturimet për riparimin e tyre bëhen konform kontratës së nënshkruar. Asnjë pagesë nuk duhet të bëhet nëse veturat e riparuar nuk janë pranuar nga personat e autorizuar.	Rekomandim i zbatuar pasi qe nga mostrat 2017, nuk ka rezultuar gjetje te ngjashme.		
3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Ministri duhet të sigurojë një rishikim në lidhje me rastin në fjalë, për të vlerësuar ligjshmërinë e marrëveshjes si dhe për të vlerësuar nëse shërbimet e kontraktuara janë ekonomike dhe sigurojnë vlerën për parën e shpenzuar.	Rekomandimi i zbatuar pasi qe nga mostrat 2017, nuk ka rezultuar gjetje te ngjashme.		

3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të punojë ngushtë me këshillat drejtuese të institucioneve vartëse me qëllim që të hartojë një rregullore gjithëpërfshirëse për angazhimin dhe pagesën e stafit për projekte të ndryshme, e cila në mënyrë të qartë do të përcaktojë procedurën e angazhimit dhe të kompensimit, ndërsa për mëditje të respektohet udhëzimi administrativ në fuçi. Duhet të zbatohen kontrole të përmirësuara për të siguruar që të gjitha kompensimet e të angazhuarave të jashtëm të bëhen përmes llogarisë bankare.			Rekomandimi i pa zbatuar pasi që edhe këtë vit janë adresuar të njëjtat çështje.
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj që të gjitha memorandumet e mirëkuptimit në mes të ministrisë dhe palëve tjera, t'i përmbajnë edhe obligimet e të dyja palëve, për arsyetimin dhe raportimin e rregullt në lidhje me shpenzimet. Poashtu duhet të shtohen kontrollet në monitorimin e shpenzimeve të krijuara nga federatat.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017.
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj që projektet e subvencionuara të monitorohen nga zyrtarët e departamenteve përkatëse në kuadër të Ministrisë, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore për raportimin dhe arsyetimin e shpenzimeve nga përfituesit e projektit.			Rekomandimi i pa zbatuar pasi që edhe këtë vit janë adresuar të njëjtat çështje.
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj që për projektet e përkrahura financiarisht, fillimisht të bëhen vendimet, kontratat, pagesat pastaj të zhvillohen aktivitetet dhe pas aktivitetit të arsyetohen shpenzimet.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017.
3.1.4 Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të siguroj që në të ardhmen, të mos subvencionohen projektet pa i plotësuar kriteret e përcaktuara nga departamenti përkatës.	Rekomandimi i zbatuar, pasi qe nga mostrat 2017 nuk ka pasur gjetje te ngjashme		

3.1.5 Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që, procedurat e prokurimit janë aplikuar gjatë realizimit të projekteve, dhe të kërkoj nga këshilli drejtues i IAK që të hartojë politika apo udhëzime gjithëpërfshirëse për angazhimin dhe pagesën e stafit për projekte të ndryshme, e cila në mënyrë të qartë do të përcaktojë detyrat, obligimet dhe kompensimit e punonjësve.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështje të njëjta janë identifikuar nga auditimi 2017.
3.1.5 Investimet kapitale	Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm për të përcaktuar pse kanë ndodhur pagesa për punët e parealizuara. Rrjedhimisht, duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme dhe kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë e identifikuar janë adresuar.	Rekomandimi i zbatuar, pasi që nga procedurat e ekzaminimit fizik në Palestrën Sportive në Istog, kemi konstatuar se për situacionet e paguara ishin përfunduar punët përkatëse.		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Ministri duhet të sigurojë që komisionet e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë përfundojnë punën e tyre dhe raportojnë me kohë, në mënyrë që menaxhmenti t'i ketë informatat e sakta rreth gjendjes së pasurive.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që çështjet e njëjta kanë rezultuar edhe nga auditimi 2017.
3.3 Obligimet e paguara	Ministri, duhet të bëjë një rishikim të procesit të raportimit të obligimeve, dhe të bëjë një vlerësim të menjëhershëm të obligimeve, për të marrë masa adekuate për përmirësimin e gjendjes aktuale.			Rekomandimi i pazbatuar pasi që edhe në vitin 2017, menaxhimi i obligimeve kishte mangësi të ngjashme.

Shtojca III: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË E PRAKTIKIMIT / DATE OF PRACTICE / DATE OF PRACTICE: 25.06.2018			
Agjensia / Org. / Jed. / Org. Unit: 03	Shit. / Klasif. / Kod / Class. Code: 47	Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 1147	Nr. / Supers. / Br. / Stranica / No. Pages: 2



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministry of Culture, Youth & Sports	
Datë / Date: 25.06.2018	Signatura / Signature: [Signature]
PRISHTINE / PRISTINA, PRISHTINA	

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omaladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth & Sports

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Kujtim Gashi



Ministër - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Data: 25 Qershor.2018, Prishtinë,